



VENDIM

Nr. 41 Datë 29.04.2013

MBI

TRANSFERIMIN E AKSIONERIT QE KONTROLLON INTERESAT E SHOQËRISE “HEC ULEZ-SHKOPET” SH.A, NGA MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKES TEK “KURUM INTERNATIONAL” SH.A

Në mbështetje të nenit 9 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, Ligjit 94/2013, datë 4.03.2013 “Për ratifikimin e kontrates për shitjen e 100 % të aksioneve të shoqërisë HEC Ulez-Shkopet të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë Kurum International”, VKM nr. 27, datë 9.01.2013 “Për miratimin e raportit përfundimtar të vlerësimit të ofertave dhe të kandidatit fitues për privatizimin e shoqërisë “Hec Ulez-Shkopet” sh.a ”, pikës 6.2 të Licensës së Prodhimit të Energjisë Elektrike, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.41 , Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), mbasi shqyrtoi kërkesën e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe aplikimit të shoqërisë HEC Ulez-Shkopet , për transferimin e kontrollit të shoqërisë HEC Ulez-Shkopet nga METE tek “Kurum International” sh.a dhe informacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

Vendosi:

1. Të miratojë transferimin e aksionerit qe kontrollon interesat e shoqërisë “Hec Ulez-Shkopet” sh.a nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikes tek “Kurum International”sh.a.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Sokol RAMADANI

Ne mungese dhe me porosi

Entela SHEHAJ